



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2248/5 prot.,

Datë 07.08.2026

V E N D I M

Nr. 953/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.08.2026 me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Alko Impex Construction” shpk dhe “Alko Impex General Construction” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF 84697-05-07-2026, me objekt: “Loti 2: Kontrata B “Mirëmbajtje me performancë e akseve kryesore të Rajonit Qendror dhe Verilindor””, me fond limit 1,097,556,828.58 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BAMI HOLDING ” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:	Operatori ekonomik “Soft & Solution” sh.p.k, me NUIS L11328009F dhe adresë: Rruga Hoxha Tahsin 113, Tiranë. Operatori ekonomik BOE “Alko Impex Construction” shpk dhe “Alko Impex General Construction” sh.p.k, me NUIS K91628013D dhe adresë: Asim Vokshi, Alb Building 2 T,K2,Tirane.
Subjekte të Interesuar:	Operatori ekonomik “BAMI HOLDING ” shpk me NUIS J94416206R dhe adresë: Rruga e Durrësit, Pallati mbrapa Ring Center, Kati I 2.
Autoriteti Kontraktor:	Autoriteti Rrugor Shqiptar, me adresë: Rruga Sami Frasheri, Nr.33, Tirane.
Baza Ligjore:	Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë ankimuar në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatori ekonomik ankimues “Soft & Solution” SHPK nuk ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi pasi nuk është pjesëmarrës, për këtë arsye nuk legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Ndërsa operatori ekonomik ankimues BOE “Alko Impex Construction” shpk dhe “Alko Impex General Construction” sh.p.k ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatori ekonomik ankimues “Soft & Solution” SHPK ka respektuar afatet ligjore, por nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, konkretisht nuk permban nje nga elementet e cituara ne ligji sic eshte mandat pagesa e cila nuk eshte paraqitur. Ankimesi BOE “Alko Impex Construction” shpk dhe “Alko Impex General Construction” sh.p.k, ka respektuar afatet ligjore dhe kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08-05-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF 84697-05-07-2026, me objekt: “Loti 2: Kontrata B “Mirëmbajtje me performancë e akseve kryesore të Rajonit Qendror dhe Verilindor””, me fond limit 1,097,556,828.58 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Data e mbylljes së fazës së parë për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje duke qënë se procedura është e kufizuar ka qënë data 11-06-2026.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor më datë 03.07.2026, ka kryer vlerësimin dhe ka njoftuar operatoët ekonomik mbi fazës për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje të operatorëve ekonomikë që kanë shprehur interesin në këtë procedurë prokurimi, përkatësisht:

1. “Bami Holding” SHPK	kualifikuar
2. “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK	skualifikuar
3. “Arbotec” SHPK	skualifikuar
4. “BE-IS” SHPK	skualifikuar

II.4. Në datën 13.07.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2026/7015, protokolluar me nr.2249/2026 prot, datë 13.07.2026, si dhe ankesa me nr. Elektronik A/2026/7017 dhe me nr. 2248/1 prot, datë 13.07.2026, si dhe ankesa me nr. Elektronik A/2026/7018 dhe me nr. 2248/2 prot, datë 13.07.2026 i operatorit ekonomik “Soft & Solution” sh.p.k, për procedurën

e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF 84697-05-07-2026, me objekt: “Loti 2: Kontrata B “Mirëmbajtje me performancë e akseve kryesore të Rajonit Qendror dhe Verilindor””, me fond limit 1,097,556,828.58 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2248/3 prot, datë 14.07.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Alko Impex Construction” shpk dhe “Alko Impex General Construction” shpk, si dhe mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BAMI HOLDING ” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në datën 13.07.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2026/7015, protokolluar me nr.2249/2026 prot, datë 13.07.2026, i operatorit ekonomik BOE “Alko Impex Construction” shpk dhe “Alko Impex General Construction” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF 84697-05-07-2026, me objekt: “Loti 2: Kontrata B “Mirëmbajtje me performancë e akseve kryesore të Rajonit Qendror dhe Verilindor””, me fond limit 1,097,556,828.58 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2249/ 1 prot, datë 14.07.2026, me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Alko Impex Construction” shpk dhe “Alko Impex General Construction” shpk, si dhe mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BAMI HOLDING ” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.8. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik, ka përcjellë me shkresën protokolluar me tonën me nr.2249/2 prot., datë 21.07.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues BOE “Alko Impex Construction” shpk dhe “Alko Impex General Construction” sh.p.k. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës. Gjithashtu shkresa me të njëjtën përmbajtje dhe me nr.6527/2 prot., datë 20.07.2026 është dorëzuar edhe në rrugë postare protokolluar me tonën me nr.2249/3 datë 22.07.2026.

II.9. Me anë të shkresës nr.149 prot., datë 27.07.2026, protokolluar me tonën me nr.2249/4 datë 29.07.2026, operatori ekonomik “Alko Impex Construction” shpk, ka dërguar nëpërmjet shërbimit postar informacionin shtesë lidhur me ankesën e sipërcituar.

II.10. Me anë të shkresës nr.2249/5, datën 06.08.2026 është deklaruar konflikti i interesit të anëtarit GJ.M të Komisionit të Prokurimit Publik pjesë e trupës gjyquese pas hedhjes së shortit, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“X Vetdeklarim

Vërtetoj se deklaramet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e tyre.

Me vetëdeklarim nuk do marr pjesë në procesin e vendimarrjes lidhur me ankesën e paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit me të dhënat si më poshtë:

Numri i referencës: me “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF 84697-05-07-2026, me objekt: “Loti 2: Kontrata B “Mirëmbajtje me performancë e akseve kryesore të Rajonit Qendror dhe Verilindor””, me fond limit 1,097,556,828.58 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Autoriteti kontraktues: Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nr.aplikimi të ankesës online: A/2026/7015, protokolluar me nr.2249/2026 prot, datë 13.07.2026.

Data e dorëzimit të deklaratës 06.08.2026.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik BOE “Alko Impex Construction” shpk dhe “Alko Impex General Construction” sh.p.k, për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tyre, me arsyen se: *“Mbasi e shqyrtuam këtë arsye skualifikimi konstatojmë se në thelb oferta jonë është skualifikuar pasi me dokumentacionin e dorëzuar nuk plotësojmë kriterin kualifikues të pikës 2.3.7” Kapaciteti teknik” të Shtojcës 11 “FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të DST-ve me argumentin se për këtë kriter kualifikues ku kërkohet disponimi I 12 (dymbëdhjetë) manovratorëve, kompania jonë është mbështetur në kapacitetet e kompanive të tjera, të cilat i kanë vënë në dispozicion 10 (dhjetë)*

manovratorë, por mbështetja në këto kapacitete nuk plotëson kriteret e pikës 2 të nenit 90 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi këtë kriter kualifikues kompania jonë duhet ta plotësonte 50% vetë (pra 6 manovratorë duhet ti ketë në stafin tonë) dhe vetëm 6 (gjashtë) manovratorë mund ti merrte me mbështetje nga kompanitë e tjera që i disponojnë këta manovratorë në stafin e tyre. Në Shtojcën 11 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të DST ve autoriteti kuaj kontraktor ka përcaktuar gjithsej 13 (trembëdhjetë) kriteret kualifikuese, si më poshtë: Për “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë” AK-ja ka përcaktuar 1 (një) kriter kualifikues, Për “Kapacitetin ekonomik dhe financiar” AK-ja ka përcaktuar 2 (dy) kriteret kualifikuese, Për “Kapacitetin teknik” AK-ja ka përcaktuar 9 (nëntë) kriteret kualifikuese, Për “Kapacitete të tjera të veçanta” AK-ja ka përcaktuar 1 (një) kriter kualifikues. Në pikën 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 11 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të DST-ve autoriteti kuaj kontraktor ka përcaktuar këtë kriter kualifikues, si më poshtë vijon: “2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 12 (dymbëdhjetë) punonjës manovratorë, Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese” per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale te punes te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme), leshuar nga institucionet perkatese, Stafi i kerkuar ne pikën 2.3.7 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.”. Kompania jonë “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk në këtë tender ka ofertuar në cilësinë e përfaqësuesit të Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “ALKO IMPEX CONSTRUCTION shpk & ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION degë e shoqërisë së huaj”, ku kompania “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk ka marrë përsipër që të realizojë 71% të preventivit që prokurohet, ndërsa kompania “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” degë e shoqërisë së huaj ka marrë përsipër që të realizojë 29% të preventivit që prokurohet. Për të përmbushur kriterin kualifikues të pikës 2.3.7 ne kemi dorëzuar dokumentacionin si më poshtë: → Shtojcën 12 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” i dorëzuar nga anëtarë i BOE kompania “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk, ku admisitratori i shoqërisë në Seksionin B “DEKLARATË, Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)” ka deklaruar se për përmbushjen e kriterit kualifikues të pikës 2.3.7 do të mbështetet në kapacitetet e shoqërive “AGRI CONSTRUCTION” shpk, “EN-SAL” shpk, “Kevin CONSTRUCTION” shpk dhe “MF INVEST GROUP” shpk, ndërkohë që në Seksionin B “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” ka deklaruar se disponon në stafin e tij 2 (dy) manovratorë. Shtojcën 12 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” i dorëzuar nga kompania mbështetëse “Kevin CONSTRUCTION” shpk, ku admisitratori i shoqërisë në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” ka deklaruar se disponon në stafin e tij 5 (pesë) manovratorë, si dhe ka dorëzuar deklaratën e mbështetjes, ku deklaroi se 5 (pesë) manovratorët e tij do të vërë në dispozicion të kompanisë tonë “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk. Shtojcën 12 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” i dorëzuar nga kompania mbështetëse “AGRI CONSTRUCTION”

shpk, ku admisitratori i shoqërisë në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” ka deklaruar se disponon në stafin e tij 2 (dy) manovratorë, si dhe ka dorëzuar deklaratën e mbështetjes, ku deklaroi se 2 (dy) manovratorët e tij do të vërë në dispozicion të kompanisë tonë “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk. Shtojcën 12 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” i dorëzuar nga kompania mbështetëse “EN-SAL” shpk, ku admisitratori i shoqërisë në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” ka deklaruar se disponon në stafin e tij 2 (dy) manovratorë, si dhe ka dorëzuar deklaratën e mbështetjes, ku deklaroi se 2 (dy) manovratorët e tij do të vërë në dispozicion të kompanisë tonë “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk. Shtojcën 12 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” i dorëzuar nga kompania mbështetëse “MF INVEST GROUP” shpk, ku admisitratori i shoqërisë në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” ka deklaruar se disponon në stafin e tij 1 (një) manovratorë, si dhe ka dorëzuar deklaratën e mbështetjes, ku deklaroi se 1 (një) manovratorët e tij do të vërë në dispozicion të kompanisë tonë “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk. Pra në dokumentacionin e ofertës kemi deklaruar se kompania jonë ka në stafin e saj 2 (dy) manovratorë, dhe se kompania “AGRI CONSTRUCTION” shpk do ta mbështesë kompaninë tonë me 2 (dy) manovratorë, se kompania “EN SAL” shpk do ta mbështesë kompaninë tonë me 2 (dy) manovratorë, se kompania “Kevin CONSTRUCTION” shpk do ta mbështesë kompaninë tonë me 5 (pesë) manovratorë dhe se kompania “MF INVEST GROUP” shpk do ta mbështesë kompaninë tonë me 1 (një) manovratorë, pra kompania jonë i ka vërtetuar autoritetit tuaj kontraktor se disponon në stafin e saj 12 (dymbëdhjetë) manovratorë (sikurse kërkohet në kriterin kualifikues), ku nga 12 (dymbëdhjetë) manovratorë që kërkohen 10 (dhjetë) manovratorë do të marrë nga kompanitë mbështetëse. Në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar është përcaktuar si më poshtë: “2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; - t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së; - në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.” Në këtë dispozitë është parashikuar nga ligjvënësi që çdo operator ekonomik ofertues për përmbushjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit lidhur me kapacitete ekonomike dhe teknike mund të mbështeten në kapacitetet ekonomike dhe teknike të kompanive të tjera që nuk janë ofertues në procedurën e prokurimit, por me kushtin që operatori ekonomik ofertues i cili mbështetet në kapacitetet ekonomike dhe teknike të kompanive të tjera duhet që të plotësojë I vetëm 50% të kriterëve kualifikues të përcaktuara në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit për të cilën paraqet ofertë, pra ligjvënësi në asnjë moment nuk ka përcaktuar se operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë I vetëm 50% të secilit kriter kualifikues dhe për 50% të secilit kriter kualifikues mund të mbështetet në kapacitetet e kompanive të tjera të cilat buk

janë ofertues në procedurën e prokurimit. Nga leximi me vëmendje i arsyes së skualifikimit të ofertës së bashkimit tonë të operatorëve ekonomikë konstatohet se anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë interpretuar gabim përcaktimet e pikës 2 të nenit 90 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi i janë referuar vetëm kriterit kualifikues të pikës 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 11 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të DST ve, ndërkohë që nuk i janë referuar të 13 (trembëdhjetë) kriterëve kualifikuesë Shtojcën 11 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të DST-ve, pasi bashkimi ynë i operatorëve ekonomikë “ALKO IMPEX CONSTRUCTION shpk & ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION degë e shoqërisë së huaj” plotësojmë të vetëm (PA U MBËSHTETUR TEK OPERATORË TË TJERË EKONOMIKË) 10 (dhjetë) kriterë të veçanta kualifikimi dhe konkretisht: “1) Kriterin për dorëzimin e Shtojcës 12 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” për “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”; 2) Kriterin e xhiros dhe 3) Kriterin e bilanceve të përcaktuara për “Kapacitetin ekonomik dhe financiar”; 4) Kriterin për shërbime të ngjashme të mëparshme, 5) Kriterin për licensën për zbatimin e punimeve, 6) Kriterin për numrin e punonjësve, 7) Kriterin për disponimin e 1 (një) inxhinieri ndërtimi i cili të jetë drejtues teknik, 8) Kriterin për disponimin e 2 (dy) inxhinier Ndërtimi dhe 1 (një) inxhinier Mekanik në personelin mbështetës, 9) Kriteri për disponimin e 1 (një) inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik 1 (një) inxhinier Mjedisori dhe 1 (një) inxhinier Topograf në personelin mbështetës për “Kapacitetin teknik” dhe 10) Kriterin për disponimin e certifikatave SSH EN ISO 9001:2015 “Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë”, SSH EN ISO 14001:2015 “Sistemet e Menaxhimit Mjedisori” dhe SSH EN ISO 45001:2023 “Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” për “Kapacitete të tjera të veçanta”.”, ndërsa 3 (tre) kriterë të veçanta kualifikimi ne i kemi plotësuar duke u mbështetur tek kompanitë e sipërpërmendura dhe konkretisht: “1) Kriterin për manovratorët, 2) Kriterin për 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” dhe 3) Kriterin për disponimin e mjetet dhe pajisjet për “Kapacitetin teknik”.”. Nga sa parashtroam më sipër, bashkimi i operatorëve tanë ekonomikë ka plotësuar i vetëm 10 (dhjetë) kriterë kualifikues nga 13 (trembëdhjetë) kriterë kualifikuesë gjithsej të përcaktuara në këtë procedurë prokurimit, duke plotësuar i vetëm 77% të kriterëve kualifikuesë, ndërkohë që ka zbatuar përcaktimet e 2 të nenit 90 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe ka dëshmuar me dokumentacionin e dorëzuar se disponon në stafin e tij 12 (dymbëdhjetë) manovratorë, sikurse përcaktohet në kriterin kualifikues të pikës 2.3.7 të Shtojcës 11 të DST-ve. NË PËRFUNDIM KËRKOJMË NGA ANËTARËT E KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË ANKESËS DHE NGA ANËTARËT E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK QË TË RRËZOJNË ARSYEN E MËSIPËRME TË SKUALIFIKIMIT TË OFERTËS TONË, PASI ME DOKUMENTACIONIN E DORËZUAR E PËRMBUSHIM KRIERIN KUALIFIKUES TË PIKËS 2.3.7 “KAPACITETI TEKNIK” TË SHTOJCËS 11 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” TË DST-ve NË PËRPUTHJE ME PËRCAKTIMET E PIKËS 2 TË NENIT 90 TË VKM NR. 285/2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, I NDRYSHUAR.”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.1.1. Në pikën 2.16 te dokumentave të tenderit është kërkuar si më poshtë vijon:

“2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohej të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo



Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohej mbështetja:

- Për të provuar përvojën e mëparshme (**shërbime të ngjashme**):

- Pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (**licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës**):

- Pika 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

III.1.2. Në shtojcën 11 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.7 “Kapaciteti teknik” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 12 (dymbëdhjetë) punonjes manovratore, Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidateve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese” per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale te punes te vlefshme, Deshmi Aftesie Profesionale (te vlefshme), leshuar nga institucionet perkatese,

❖ Stafi i kërkuar në pikën 2.3.7 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.”

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, BOE “Alko Impex Construction” shpk dhe “Alko Impex General Construction” sh.p.k, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

-FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT “Alko Impex General Construction” sh.p.k

Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor. Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve : Janar 2026-xxx punonjes Shkurt 2026 – xxx punonjes Mars 2026-xxx punonjes Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/ kualifikimeve) përkatëse: 1. Znj.A.D.K me profesion Inxhinieri Mekanike, e punësuar pranë shoqërisë sonë.

B: DEKLARATË PËR NËNKONTRAKTORËT DHE SUBJEKTET NË KAPACITETET, E TË CILAVE DO TË MBËSHTETET OPERATORI EKONOMIK

(nëse është e zbatueshme)

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et
“Agri- Construction”Shpk	K01725001F	Kapacitet teknik dhe profesional	Piken 2.3.7 punonjes manovrator, dhe piken 2.3.9 mjetet dhe pajisjet.
“EN-SAL ”Shpk	K 83520201 V	Kapacitet teknik dhe profesional	Piken 2.3.7 punonjes manovrator, dhe piken 2.3.9 mjetet dhe pajisjet.
“MF INVEST GROUP” sh.p.k	L71830010R	Kapacitet teknik dhe profesional	Piken 2.3.7 punonjes manovrator, dhe piken 2.3.9 mjetet dhe pajisjet.
“Kevin Konstruktion” sh.p.k	K71401004W	Kapacitet teknik dhe profesional	Piken 2.3.7 punonjes manovrator, 2.3.8 Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave dhe piken 2.3.9 mjetet dhe pajisjet.

-FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” SHPK

Deklarata Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor. Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve : Janar 2026-xxx punonjes Shkurt 2026 – xxx punonjes Mars 2026-xxx punonjes. Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/ kualifikimeve) përkatese: 1. I.P , me profesion Inxhinier Ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit Teknik . 2. K.S, me profesion Inxhinier Ndertimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë 3. E.L, me profesion Inxhinier Ndertimi e punësuar pranë shoqërisë sonë. 4. V.G, me profesion Inxhinier Gjeoteknik i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtuesit Teknik. 5. L.P, me profesion Inxhinier Mjedisi i punësuar pranë shoqërisë sonë. 6. E.M, me profesion Inxhinier Topograf i punësuar pranë shoqërisë sonë. 7. J.R, e punësuar pranë shoqërisë sonë, , e pajisur me certifikate “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”; 8. L.D, me profesion Manovrator i punesuar prane shoqerise sone. 9. I.S, me profesion Manovrator i punesuar prane shoqerise sone.

-FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT “Kevin Konstruktion” shpk,

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	“Kevin Konstruktion”Shpk Operator mbeshtetes

B: DEKLARATË “PËR DISPONIMIN E PUNONJËSVE TË NEVOJSHËM PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE” Deklarata Përgjigje, Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve : Mars 2026- xx punonjes kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor. Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/ kualifikimeve) përkatese: 1. A.A, me profesion Manovrator i punesuar prane shoqerise sone. 2. A.Q, me profesion Manovrator i punesuar prane shoqerise sone. 3. A.S, me profesion Manovrator i punesuar prane shoqerise sone. 4. M.J, me profesion Manovrator i punesuar prane shoqerise sone. 5. E.Gj me profesion Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave i pajisur me Deshmi Aftesise Profesionale si Manovrator i punesuar prane shoqerise sone.

-FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT “En-Sal” shpk

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	"EN-SAL "Shpk Operator mbështetës
Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve : Mars 2026-----30----- punonjës Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. Z. me profesion Manovrator i punësuar pranë shoqërisë sone. 2. Z. me profesion Manovrator i punësuar pranë shoqërisë sone.

-FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT "MF INVEST GROUP" SHPK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	"MF INVEST GROUP" SHPK Subjekt mbështetës i : "ALKO IMPEX CONSTRUCTION" SHPK
Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:	Punonjës
Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve : Muaj Mars 2026 – 61 (gjashtëdhjetë e një) punonjës Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. Z. me profesion Manovrator i punësuar pranë shoqërisë sone.

-FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT "Agri-Construction" SHPK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	“Agri- Construction” Shpk, Operator mbeshtetes
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: 80 punonjes, muaji Mars - Prill 2026 Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. Z. [] me profesion Manovrator i punësuar pranë shoqërisë sone. 2. Z. [] me profesion Manovrator i punësuar pranë shoqërisë sone.

III.1.3. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet:

1. *Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.*

2. *Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.*

3. *Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

4. *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.*

5. *Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.*

6. *Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.*

7. *Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. *Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;*
- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.*
- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.*
- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.*

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit.

Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme

për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kapacitetin teknik ka kërkuar që **“2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 12 (dymbëdhjetë) punonjes manovratore, Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese” per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale te punes te vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (te vlefshme), leshuar nga institucionet perkatese[...]**”

Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.1.2. të këtij vendimi. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit dhe referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se ankimuesi ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si subjekt mbi të cilin do të mbështetet sa i takon pikës 2.3.7 të kapacitetit profesional, operatorin ekonomik “Agri- Construction”Shpk, “EN-SAL ”Shpk, “MF INVEST GROUP” sh.p.k, “Kevin Konstruktion” sh.p.k, shoqëruar me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe deklaratën e angazhimit të secilit prej tyre, të cilët angazhohen posaçërisht për të mbështetur operatorin ekonomik BOE “Alko Impex Construction” shpk & “ALKO - IMPEX General Construction” shpk me Kapacitet teknik dhe profesional konkretisht pikën 2.3.7 punonjes manovrator, dhe pikën 2.3.9 mjetet dhe pajisjet, si dhe pikën 2.3.8 Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave. Në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, është përcaktuar qartë se: *“2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;”* Akoma më tej në pikën 4 të nenit 90 të aktit nënligjor të sipërpërmendur është përcaktuar që: *“4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”*.

Në rastin konkret, duke gjykuar se operatori ekonomik BOE “Alko Impex Construction” shpk & “ALKO - IMPEX General Construction” shpk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht në seksionin përkatës në pikën B, *“Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik”* si subjekt mbështetës operatorit ekonomik “Agri- Construction”Shpk, “EN-SAL ”Shpk, “MF INVEST GROUP” sh.p.k, “Kevin Konstruktion” sh.p.k, lidhur me plotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.7 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë, KPP gjykon t'i drejtohet parashikimeve të pikës 4 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar . Referuar parashikimeve më sipër duhet që operatori ekonomik BOE “Alko Impex Construction” shpk & “ALKO - IMPEX General

Construction” shpk, si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera, të plotësojë 50% të kërkesës së përcaktuar në pikën 2.3.7 të kapacitetit profesional, ndërkohë ankimuesi, rezulton të jetë mbështetur me mbi 50% të kërkesës të subjektet mbështetës “Agri- Construction”Shpk, “EN-SAL ”Shpk, “MF INVEST GROUP” sh.p.k, “Kevin Construksion” sh.p.k, të deklaruar si subjekt mbështetës në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, çfarë bie ndesh edhe me parashikimet e dispozitës më sipër. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik konkretisht parashikohet se: *“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij.* Komisioni gjykon se duke e konsideruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera kur kjo gjykohet e nevojshme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi si një kusht të rëndësishëm për plotësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale, si dhe për vetë ecurinë e kontratës, në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik është përcaktuar që jo vetëm duhet të deklarohet në dokumentet e ofertës mbështetja në kapacitet e subjekteve të tjera, por janë përcaktuar edhe kriteret për këtë mbështetje, njëri prej të cilëve është që në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor, dispozitë e cila në rastin konkret me dokumentacionin e paraqitur nuk plotësohet nga ankimuesi, pasi ai është mbështetur me mbi 50% të kërkesës së përcaktuar në pikën 2.3.7 të operatorët ekonomik “Agri- Construction”Shpk, “EN-SAL ”Shpk, “MF INVEST GROUP” sh.p.k, “Kevin Construksion” sh.p.k, lidhur me Kapacitetin profesional pikën 2.3.7 të DT, punonjësit e nevojshëm, sikurse provohet nga deklarimi i bërë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor sa i takon kriterit 2.3.7 të dokumentave të tenderit dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik BOE “Alko Impex Construction” shpk dhe “Alko Impex General Construction” sh.p.k, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “BAMI HOLDING” shpk, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik BOE “Alko Impex Construction” shpk dhe “Alko Impex General Construction” sh.p.k, nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. do të mbetet i skualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “BAMI HOLDING” Shpk, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, ai do të mbetet i skualifikuar. Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimuesit nuk do të merren në shqyrtim.

III.3.1. Parashikimi i nenit 110 e vijues të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenit 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm për të dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin që dëmton OE.

III.3.2. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.3.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës, për sa

kohë që do vijoj të mbetet i skualifikuar edhe pas ankesës së bërë prej tij në KPP. Pra, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka se si të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi. Pasi për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve mbi skualifikimin e padrejtë të ofertës së dorëzuar prej tij, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoj se këto të fundit nuk qëndrojnë dhe në këtë mënyrë ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe gjendja faktike, juridike e operatorit ekonomik BOE “Alko Impex Construction” shpk dhe “Alko Impex General Construction” sh.p.k, do të vijojë të mbetet i skualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimuese për s’kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “BAMI HOLDING” shpk, nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tij, për këtë operatorë ekonomik pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Soft & Solution” SHPK, për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF 84697-05-07-2026, me objekt: “Loti 2: Kontrata B “Mirëmbajtje me performancë e akseve kryesore të Rajonit Qendror dhe Verilindor””, me fond limit 1,097,556,828.58 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Alko Impex Construction” shpk dhe “Alko Impex General Construction” sh.p.k për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF 84697-05-07-2026, me objekt: “Loti 2: Kontrata B “Mirëmbajtje me performancë e akseve kryesore të Rajonit Qendror dhe Verilindor””, me fond limit 1,097,556,828.58 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kalimin në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik BOE “Alko Impex Construction” shpk dhe “Alko Impex General Construction” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu

